



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 270, datë 24.08.2020

**PËR
MIRATIMIN E KËRKESAVE BUXHETORE, PBA 2020 - 2022 (FAZA E DYTË), TË
SISTEMIT GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës, në nenet 95 dhe 96 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021 – 2023” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021 – 2023” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesave buxhetore PBA 2021 – 2023 (*faza e dytë*) të sistemit gjyqësor (KLGJ dhe Gjykatat), sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Pasqyra nr.1,

Pasqyra
e kërkesave buxhetore, për sistemin gjyqësor (KLGJ + Gjykatat), 2021-2023

000 lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Viti buxhetor 2021</i>		<i>Viti buxhetor 2022</i>		<i>Viti buxhetor 2023</i>	
	<i>Kërkesa</i>	<i>Tavani</i>	<i>Kërkesa</i>	<i>Tavani</i>	<i>Kërkesa</i>	<i>Tavani</i>
Shpenzime korente (600-601-602)	3,645,250	3,244,200	3,650,250	3,244,200	3,654,250	3,273,150
Shpenzime kapitale (230-231)	207,000	200,000	360,000	200,000	325,000	0
Totali	3,852,250	3,444,200	4,010,250	3,444,200	3,979,250	3,273,150

Pasqyra nr.2,

Pasqyra
e kërkesave buxhetore, për programin programin 01110 “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, viti 2021,

000 lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Programi 01110 “Planifikim, Menaxhim, Administrim”</i>		
	<i>Kërkesa buxhetore 2021</i>	<i>Tavani</i>	<i>Diferenca kërkesë-tavane</i>
Shp. personeli (600-601)	215,000	215,000	0
Shp. operative (602)	60,000	60,200	-200
Shp. Korente (600,601,602)	275,000	275,200	-200
Shp. investime (230-231)	22,000	15,000	7,000
Totali	297,000	290,200	6,800

Pasqyra nr.3,

Pasqyra
e kërkesave dhe tavaneve buxhetore, për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, viti 2021,

000 lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”</i>		
	<i>Kërkesa buxhetore 2021</i>	<i>Tavani</i>	<i>Diferenca kërkesë-tavane</i>
Shp. personeli (600-601)	2,806,250	2,532,000	274,250
Shp. operative (602)	564,000	437,000	127,000
Shp. Korente (600,601,602)	3,370,250	2,969,000	401,250
Shp. Kapitale (230-231)	185,000	185,000	0
Totali	3,555,250	3,154,000	401,250